



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË DYTË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.02.2019 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Valbona Haziri, Afrim Ramushi, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, ndërsa munguan Vjollca Kadolli-Halili, Rufadije Halimi-Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI-së mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e dytë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni. MAPL-ja naj ka konfirmu ligjeshmerin e disa nga aktet e miratuara ne seancën e fundit ndersa nje naj kthy ne rishqyrtim ku sot e kemi rikthy ne Kuvend.

znj.Mirlind Sadiku: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa pyetje. Procesi i bursave, edhe pse është hap konkursi qysh në muajin Nëntor, ende nuk ka publikim të bursave. Dijet që kjo shkon me vit shkollor akademik 2018-19, pse ende nuk janë publiku bursat. Sipas bisedave që kam pas me këshillin e prindërve, që janë në çerdhen gëzimi ynë, ata kanë vendos që mos me pagu muajin Janar, mirëpo ju është be presion nga drejtoria që të behet pagesa. Ne e dimë që muaji janar kemi qenë me grevë profesorët, shkollat, po ashtu edhe punëtoret e çerdhes, nëse keni një përgjigje nënkryetar, po ashtu nëse ke përgjigje drejtori i Financave. Tek rehabilitimi i rrugës Viti-Letnic, kostoja e tij ka qenë 150 mijë euro. Kjo rrugë është përfundua ne fund të vitit 2018, kodi buxhetor 15-295, e di që është bashkëfinancim, nëse ke mundësi me na dhënë përgjigje a është pranu teknikisht kjo udhë, sepse vija e mesit e cila e ndan udhën në dyshe, ajo nuk është vendos. Më intereson ta di, a është pranu teknikisht?

z.Zekrija Zuka: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Dola për të shprehur një breng për shkatërrimin dhe dëmtimin e pyjeve, ato po dëmtohen në dy mënyra, një duke i preh dhe dy duke hedhur mbeturina. Të paret, për çdo ditë se paku dhjetëra kuaj me samar, sharrë elektrike presin drunj të rinj, filiza, sepse drunj të trasha ma nuk ka dhe as kush nuk i pengon. Komuna jone këtë vit ka shpall vit të ambientit, të ruajtjes së pyjeve, por nuk po

mjafton me kaq. I lus të gjithë akteret relevant, duke filluar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë, rojet e pyjeve, Policinë e Kosovës, ekzekutivin e Komunës, shoqërinë civile, e sidomos qytetarët vitias, që të ruajnë këtë pasuri që naj ka dhënë natyra. Është koha e fundit që t'i thomi stop kësaj dukurie të shëmtuar. Shfrytëzoj rastin që të përgëzoj Drejtorinë e Shërbimeve Publike, posaçërisht drejtorin, për menaxhimin e rrugëve, që gjatë ditëve të ftohta, largimin e bores e ka bë me kohë dhe shpejt, duke u mundësuar qytetarëve që të lëvizin me mënyrë të lehtë për kryerjen e punëve dhe obligimin e tyre.

z.Taulant Haxhiu: I nderuar kryetar Pira, nënkryetar ju të pranishëm! Unë e morra një regjistër të punëtorëve që kanë qenë me kontratë mbi vepër, atë që e kam kërku unë, po këtu nuk është bash informata shumë reale, se qysh e kam kërku une, sepse këtu janë shumë emra e nuk po cekte se kush është aktiv tash e sa nuk janë. Unë po e shof këtu një shpenzim enorm të kryetarit Haliti, i cili i ka bë 100 e 2000 mije euro e 943 shpenzime për militant partiak këtu kemi dy kundërshtarët me të mëdhaj të kryetarit Haliti, që i ka pagua për t'i pas ngat veti pa nevoja. Kemi Daut Xhemajlin, i cili ka qenë kryetar i PDK-së dhe ka qenë kundërshtari me i madh i Sokol Halitit, të cilin e ka lan 8 vjet në opozitë, e Sokoli për me kthye ngatë veti me politiken e tij që e ka hargju për ta, 2400 euro, ka 600 euro e ka pagua, vetëm për shkak që me mbajt afër vete Daut Xhemajli. Ai ka pas edhe dikan që ka qenë nxënëse i tij, pastaj ka qenë kundërshtar me të mëdhaj brenda subjektit të tij, e ai është Samet Dalipi. Dijet që mas Sametit ka ardh u bë kryetar i Komunës, Samet Dalipi ka qenë edhe para luftës edhe mas luftës kryetar i parë i LDK-së Samet Dalipi, si këshilltar të vetin, për shkak që mos mi dal mbrapa ky diktatori vitias, ka dhënë 6050 euro për ta, kështu që dine qytetar të nderuar, që Sokol Haliti të gjithë këta persona që i ka marr i ka marr për mos me pas konkurrencë politike edhe për atë e kam qujt, që ai është King Jongu i Vitisë. Lus unë, nuk po e di kush është aktiv sot, në 2019-të nuk i keni cek, kjo informatë është e mangët, unë du me e dit kush është sot e kush u kanë deri dje. E kam lyp edhe një informatë për shpenzimet e urës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë! Kam një pyetje për drejtorin e Financave, për projektet në Viti. Është fjala për dy rrugët që janë asfaltu, rruga "Hasan Prishtina", edhe kjo rruga te rrethi, te xhamia ne drejtim të QKMF-se. Çka ka ndërmarr Komuna e Vitisë, apo drejtori ndaj këtyre kompanive të papërgjegjshme për punët që i kanë kry jashtë cilësisë së kërkuar. Hapat konkret çka i keni ndërmarr ju, dhe a kanë pranim teknik, këto rrugë.

znj.Idajete Pira: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Gjendja shumë e rëndë në shkollën fillore "Halil Alidema" në Pozharan, dita me ditës po e rrezikon nxënësit zvarritja e punës në këtë shkollë ne ndërtim, rrezikon shëndetin në këtë shkollë. Para pak dite, nxënësve u kishte ikur vëmendja nga mësimet dhe ishin përqendru në ingjizimin e minjeve neper klasë të cilët bejshin manovrimet e tyre. Përpos kësaj, vaj halli për nxënësit në Pozharan, kur fryn era, po ashtu edhe për mësimdhënësit, detyrohen që nxënësit ne rreshtin nga dritarja ti transferojnë ne dy rreshtat e tjerë, për arsye se xhamat thehen prej erës. Janë krejt të dëmtuara. Para disa dite, unë kam pas një rast, një nxënësit të cilit gjatë fryrjes se erës i është thyer xhami dhe i ka ra në shpinë, mirëpo fatmirësisht lëndimet kanë qenë shumë të vogla, nuk e dijë a jeni në dijeni për këto gjëra, apo i keni mbyll sytë. Unë e dijë që nuk është në kompetencat e juaja, por duhet me i përshpejtu dhe me kontakti me kompaninë kontraktuese, që me i përshpejtu punët, se qysh ja kanë nis këto leje që nuk kryhet ne afatin e paraparë po si duken do të shkoj edhe me vite të tëra. Edhe çështjen e kanalizimit që vjen prej Sllatinës në Lagjen e Muhagjerëve, aty kanë pëlsitur gypat dhe qaq kanë dal ujërat e zeza mbi sipërfaqe, që unë mendoj që ato kanë me shkakti probleme të mëdhaja, përpos që është kundërmimi shumë i madh, ka me pengu edhe punimin e arave, livadheve përreth aty. Këtë e dinë edhe kryesuesi, qaq shumë është rrit shavari dhe bari, sa tash vetëm po fillon koha mu nxeh edhe aty ka me pas mushkonja që ato kanë me qenë bartëse të sëmundjeve të ndryshme infektive, pasojat kanë me qenë këtu. Nuk e di sa jeni ne dijeni për këtë, ama që disa vite kryetari është deklaruar, që kemi me e rregullu këtë problem, mbes me shpresë që të përfundon kjo.

z.Naim Pira: Faleminderit doktorres, vërtet shkolla e Pozharani është ne çfarë gjendje është, e dimë, është kompania e cila e ka një afat dinamik për kryerjen e punëve deri ne fund të këtij viti, institucionet komunal, po edhe unë si kryesues i kuvendi në vazhdimësi kemi bë përpjekje dhe trysni që në afatin optimal të kryhen punët. Shpresoj që të përfundojnë punë, edhe me ministrin kemi kontakti që na kanë premtu që do ta mbështesin financiarisht dhe shpresoj që të përfundon brenda afateve kohore.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje kryesues, nënkryetar dhe ju të pranishëm! Kam një pyetje për drejtorin e Kulturës. Sa i përket stadiumit sintetik, ku janë punët dhe a është në përfundim e sipër, që për mu është shumë me rendësi, se nëse përfundon do të ju hinë në shërbim të rive të Komunës së Vitisë dhe shumë ekipeve që funksionojnë në Komunën e Vitisë. Me disa parafolës nuk do të merrem, ato që u thanë nuk qëndrojnë.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam disa pyetje, një për drejtoreshën e Gjeodezisë, a është e vërtet që në dikasterin e juaj që ju e drejtoni, janë grumbulluar shumë lëndë dhe nuk janë sistemuar duke lënë palët të presin me ditë të tëra në mungesë të dy punëtorëve dhe nëse është ashtu, së paku unë kam kështu informatën nga personat që nuk kanë mujt me kry punë dhe nëse është ashtu çka mund të na thuani a keni marr ndonjë masë apo ndonjë vërejtje, apo keni bë ndonjë veprim konkret, dhe pyetja tjetër çështja e ndërtesës së Komunës, vërtet po e teproj se shpesh e kam përmend këtë, po megjithatë e di përgjigjen që nuk është projekt i drejtpërdrejt i komunës. Po a mund ta dimë që ne jemi këtu ata që duhet të vendosim, ne jemi damaqini. Nëse nuk keni diçka konkrete, po ju njoftoj, që ne ndoshta do të dalim me një konferencë për shtyp lidhur me këtë, se vërtet është zgjat. Në seancën e kaluar i kam bë dy pyetje, njëren kryetarit që e ka anshkalu për dy rrugët ne Remnik dhe pyetja tjetër drejtorit për Shërbime Publike për projektin e dritave në fshatin Remnik dhe kam cekur, që nëse nuk ka mundësi me më sjell pyetje me shkrim, se di a ma ka sjell a jo, se deri kur është mërri me at projekt.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderur të pranishëm! Isha lidh në disa pyetje për drejtoreshën e Kadastrit. Sa është e vërtet që ti drejtoresh e ki dhen një vërejtje një punëtorit që nuk vjen në punë dhe të nesërmit je detyru prej kryetarit me jek atë vërejtje që e ki dhënë dhe të kanë bë problem, kjo është e vërtet. Po tash ti qysh naj shpjegon këtë me naj dhënë një sqarim. Për drejtorin e Shëndetësisë, çfarë masa ka ndërmarr tu e ditë që është një epidemi e gripit tash që është në Kosove dhe është formu edhe në nivel të Kosovës komiteti që e mbikëqyr këtë, se është një gjendje serioze ne Kosovë. Çka ke ndërmarr ne Viti ne këtë aspekt? Edhe te pyetja tjetër të punëtorët, që kjo kompania që e pastron qytetin ato punëtor çdo ditë kanë vërejtje janë nja 5-6 që myte tu fshi qetu pari dhe rrogat ju vonohen shumë, zakonisht ato bëjnë presion për rroga, ju nuk dini çka me ju dhënë përgjigje po shpesh ju thoni deshi punoni, nëse nuk punoni ka tjerë që vinë, pse është kjo, na kemi ndëgju që prej kësaj kompanie paguhen edhe disa punëtor të tjerë që i keni shti në lista, e ata nuk vinë në punë, ata marrin pare, sillen në komunë e rrinë në fajsbuk tu i përcjell takimet, komentet, fushatat që i bjenë partitë tjera dhe japin informata nëpër zyrat e kryetarit Sokol Haliti. Kjo është e papranueshme, se dikush me marr pare ne këtë formë për me nejt ne fajsbuka, e dikush tjetër punon e ju vonohen rrogat dhe kërcënohen, kjo është shumë jo njerëzore, kjo është e nivelit ma të ultë njerëzor që mundet të behet.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sot do ta shtroj një problem i cili është i ka motshëm mu ne qendër të Vitisë, i cili paraqet shume rrezik për qytetarët dhe sidomos për nxënësit e shkollave të mesme. Problemi qëndron të restaurat “Lindi”, ajo pjesa ku nuk ka tretuar. Unë e di që ky problem është i kamotshëm, mirëpo do zgjidhje të domosdoshëm. Nuk e di a keni provu me atë zotërinë, pronarin e restaurantit me bë zgjidhje kur e dimi që pjesa e trotuarit aty shkëputet nja 20 metra, apo sa ka gjatësi, normal është pronë private me sa e di unë, mirëpo duhet me gjet një zgjidhje normal me ja kompenzu edhe me bë një zgjidhje afatgjate. Aty nënstop rrezikohen nxënësit, qytetarët po edhe për shoferët është problem. Unë mendoj që është e domosdoshme me bë një zgjidhje, pa marr parasysh koston sa kushton, pa e dëmtuar as pronarin e restaurantit. Kam një pyetje edhe për drejtorin e Shërbimeve Publike në rrugën “Hasan Prishtina”, një kanal atje e keni hap, se ka qenë i mbyllur,

mirëpo disa qytetar të pandërgjegjshëm aty kanë dal dhe e kanë mbyll, bile bile ka ardh deri te ngatërresa në mes të qytetarëve, që mendoj që ju si institucion nuk guxon me e leju me ndodhe kjo. Edhe një pyetje për drejtoreshën e Arsimit, a ka me pas nxemje këtë vit në shkollën ku punojmë ne apo jo. Në seancën e kaluar është fol mjaft për digjitalizimin e shkollave, nuk e di, po me doket kontrast i madh me fol shumë për digjitalizimin, e kur ende senet elementare në shkollë, nxemjet nuk i kemi. Po ashtu edhe pyetjet që do ta vazhdoj deri ne fund të mandatit, uji i pijshëm në fshatin Gërmovë dhe Gushica ka fillu me vitet të tëra jemi bërë bajat edhe na tu e përmend, po qytetarët janë të interesuar me dit a kanë me pas ujë edhe këtë vit apo jo.

z.Rasim Terziqi: Përsëritje të nderuar të pranishëm! z.Alia tha për stadiumin, më ngacmoj, se kurrë ma nuk kam pas me fol për këtë, se ajo punë është shumë e ndjeshme për Pozheranin. E ke qu vet atje ne Sadovinë, luani tash nëse ka kush me luajt atje, shfrytëzonte, tash e ki obligim me shfrytëzu, ama nuk ka kush me luajt atje sepse ai është stadium i Pozharanit. Nënkrjetar, tek trotuari ne rrugën e Pozherani-Viti, çka po ndodh, janë ndërpre punimet moti, nuk është tu përfundu. Unë e di që ka dal një problem si kontest pronësor, ama ju duhet me e zgjidh atë problem, edhe nuk e di vetëm ne Pozharan po qëllonjë qeto kompani që po kontraktohen te këqija, kompania e shkollës e keqe, e trotuarit e keqe, e stadiumit “Ibrahim Kurteshi” e keqe, unë nuk po di çka po ndodhë vetëm me Pozharan kjo. E kemi një trotuar në fshatin Tërpezë që është e domosdoshëm mu kry. Paramendoni, kryeni ju shëtitore, që ato shëtitore i hecin nja 20 vet brenda ditës, nuk e kryeni një tretuar që është i domosdoshëm. Fëmijët ishin të rrezikuar ne Terezë, katastrofë nëpër rrugë tu shku ne shkolla, unë nuk di përbesë qysh po i rendoni këto investimet. Asfaltimi i rrugës të tërpezëve në Radivojcë, pse krejt rrugët në Radivojcë i keni asfaltu, vetëm rrugën e Tërpezëve që nuk janë ata votues potencial të LDK-së nuk e keni kry at rrugë.

znj.Liridona Bislimi: Përsëritje të nderuar të pranishëm! Më intereson ta di çka ka ndodhur me rrugën e Sllatinës së Epërme, konkretisht nga rruga e shkollës deri në Dardani, për çfarë arsye janë ndërpre punimet dhe pse qytetarët vazhdojnë të jenë të irrituar me kryetarin Sokol Haliti, kur dijet se në fillim rrugën ja ka premtuar 6 metra, pse nuk është shtru ende kjo rrugë. Gjithashtu rruga “Hasan Prishtina”, e cila rrugë është për Pozharan, që u përmend sot, nuk ka trotuar. Qytetarët kanë kërkuar që ta paraqes rrezikun që banorëve ju kanoset dhe janë të shqetësuar dhe kur do të ndërtohet ky trotuar i cili ish premtu tash e pesë vite vazhdimisht gjatë zgjedhjeve. Gjithashtu në fshatin Drobesh, në hyrje të fshatit përball rrugës Eesley Clark, është një rrugë afër dy kilometra, që ishte pa emër, banoret kanë probleme të mëdha me kanalizim, rreth dy vite ish ky problem, banorët kanë probleme me kanalizim, ujërat e kanalizimit u hynë ne shtëpia e ne bodrume me erëra e kundërmim. po çka ish me shqetësuese për faktin se në fund të kësaj rruge ujërat e kanalizimit grumbullohen e aty banoret i kishin serat, ku shumica prej atyre serave edhe e nxerrin kafshatën e gojës edhe të njëjtin problem identik e kishin banoret ne rrugën “Gursel e Bajram Sylejmani” nga fillimi i rrugës deri te xhamia e fshatit.

Nënkrjetari z.Hasan Aliu: Përsëritje të nderuar të pranishëm! Pat shumë pyetje ne adres të ekzekutivit, do të bëjë përpjekje të ju përgjigjem, ka edhe pyetje që me duhet të marr informata, sepse pat pyetje për lagje të ndryshme, po filloj me procesin e bursave. Formimi i komisionit ekziston, është çështja, sepse për shkak të motit e kemi shty procesin e zgjedhjeve të këshillave të fshatrave, dhe kemi anëtarin i cili është i involvuar edhe në komisioni e bursave, e besoj që shumë shpejt do të kryhet edhe çështja e bursave. Këshilli i Prindërve, grevat, pagesat e paskan kerku te çerdhja. Unë besoj se greva ka qenë në nivel të Republikës së Kosovës, ka qenë krejt për punëtorët arsimor, unë besoj që çështja e pagesës ndoshta ne nuk duhet me ndërhy, duhet me pa si veprohet në Kosove, qashtu me shku njëjtë, tash a është e drejtë me pagu ajo është çështje tjetër. Çështja e rehabilitimit të rrugës Viti-Letnicë, me siguri drejtori i ka informacionet, po e di që nuk është pranë teknikisht se i mungojnë shumë çështje të cilat do ti shiheni me vonë, ka qenë investim i ministrisë. Zeka e ceku shkatërrimin e pyjeve, më vjen mirë për apelin që e bëre, ato janë pasuri e jona, mujmë me i mbrojtë bashkërisht me gjithë mekanizmat edhe institucional edhe jashtinstitucional. E di që je shume aktiv në përcjellje edhe qytetarët janë ata që munden

me i mbroj me se shumti, e falënderove drejtorin, e ka obligim drejtoria po mundet me marr notën me të madhe. Punëtorët me shërbime të veçanta, vetëm duhet t'i qartësojmë, nuk jam për me e mbrojt kërkan po as me e sulmu kërkan me emra, nuk po du mu marr ama as arsye me të thanë pse ti i përmend emrat, sepse çdo këshilltar i Kuvendit Komunal e ka qasjen e vet se si i qaset problemit, po megjithatë dikush duhet me punu në Zyrën e Investimeve, a do të jem unë apo ti dikush duhet me qenë, para tij ka qenë një tjetër, ka gjetë punë me të mirë, ai e ka lëshu tash e kemi marr këtë që është. Ndërsa çështja tjetër, ne e kemi pas projektin me Krosborderin, dikush duhet me qenë menaxher i atij projekti, ka muj me qenë edhe nga stafi i brendshëm që veprojnë disa komuna për shkak të papunësisë së madhe. Kryetari e ka parapa dikan tjetër, unë besoj se asnjë të keqe nuk ka dhe kjo është pagu nga mjete që hyn e dalin përmes zyrave tona, ndërsa janë mjete që janë fitu me projektin e krosborderit nga komunat nderkufitare, megjithatë duhet të evidentohen tek, po nuk janë parë të taksapaguesve, qytetarëve të Komunës së Vitisë, po as të Republikës së Kosovës. Informatën e urës ta ka sjell drejtori. U ngrit shqetësimi për dy rrugë, ku edhe për neve është shqetësim, e kam thirr një takim të progresit së bashku me kompaninë e cila është nënshkruese për dy rrugët të cilat me plot të drejt e ngrit at shqetësim që është shqetësim edhe per mu edhe per kabinetin dhe u zotu para neve se kame kerku me kem ngulje se bashku me drejtorin, mbikëqyrësin e projekteve dhe zyrën e prokurimit se momentin e krijimit të kushteve ne muajin Mars ato do të grryhen dhe serish kemi kërkuar të ri asfaltohen se ne qat form nuk munden mu pranu prandaj do ta presim kohën dhe jam pro çdo vendimi që është i drejt dhe ato rrugë t'i kthejmë në gjendjen qyshe duhet me qenë, e pranor edhe ai, kërkon falje ai i cili ka qenë nënshkruer i kontratës. Gjendja e rënde në shkollën "Halil Alidema", pajtohemi plotësisht, po megjithatë kemi bërë përpjekje edhe na maksimale që në atë shkollë me i formu kushtet me të përshtatshme që me mujt ata nxënës deri ne përfundimi e objektit shkollor me i vazhdu mësimet aty kemi bërë intervenime, shkolla e ka një afat, kujtoj që sivjet është viti i fundit. Kryesuesi së bashku me kryetarin kanë qenë në takim prej ministrisë dhe punëkryesi u kërku decitivisht që këtë vit të përfundohet edhe unë jam që me be trysni maksimale që njëherë e përgjithmonë mi thanë asaj shkolle lamtumirë e me dal në objektin e ri qysh e meritojnë nxënësit tonë. U cek kanalizimi, kemi pengesa jo vetëm në Pozharan po kemi plotë probleme të kanalizimeve dikun me fajin e punëkryesve, dikun me fajin e qytetarëve. Ide nuk ka, se po naj bien ato ingjizimet se çka po hudhin, po besoj që kanë me na ardh ditët me të mira. Çështjen e grumbullimit të punëve në Drejtorinë e Katastrit. Është e evidente për shkak se është edhe koha qetasht e aplikimit për kredi, për shkak të bizneseve munde të grumbullohen, megjithatë i takon përgjegjësit të sektorit, drejtoreshës të merret me ato hapa dhe konsideroj që është një aspekt i brendshëm, mirëpo ngritja e shqetësimeve është me vend. U tha për ndërtesën e komunës, si çështje të cilën e ngrite, plotësisht pajtoj si çështje që thu, unë përndryshe do të mbaj konferencë, është bindje e jotja për konferencë, dil nuk ka dilemë, keni të drejtën me mbajt konferencë nëse mendon që me rastin e mbajtjes së konferencës do ta ngrit apo do ta shtyn përpara, megjithatë unë kam qenë akter këtu kur ka ardh një komision të cilët sikur sot shkrun në email të kryetarit se nesër vim dhe ju duhet me dal të komuna e re. Unë kam dal, ka qenë kryesuesi dhe ingjineri ka qenë Xhelal Musa dhe kur dalim aty ishin kanë tu i kry disa punë të thjeshta teknike dhe kërkuan me këmbngulje që unë me e pranor objektin dhe si të tille unë nuk e kam pranor, sepse nuk ka kushte. Unë nuk jam ingjiner, ama në familje kam ingjiniera të ndërtimtarisë dhe nuk pranohet objekti tu punu tu ngjit qeshmë se nuk e di a funksionon apo nuk funksionon. Për mu pranor duhet me qenë stafi jashtë edhe kam kërku me pru një kontratë, cilat punë kanë pas ata mi kry dhe cilat nuk kanë pas dhe ati zotnisë i ka ardh shumë zheg për këtë çështje. Për fat të mirë ka qenë një ingjiner i quajtur me emrin Sami, që po punojke në ministri, që ka qenë plotësisht në anën e këtyre që i kam kërkuar unë dhe e kam falënderuar shumë, unë nuk kam kërku diçka personale time, po kam kërku diçka që duhet me pas. Unë i kam thanë jam në gjendje me pranor në momentin që ma sjell projektin, kontratën, e ta shof çka ke pas me kry e çka nuk e ke kry, Dje kryetari ka pas takim me dy sekretaret e ministrive dhe e ka ngrit si çështje dhe na tash kemi fillu me pjesë që e kemi zbulu që ata nuk e kanë pas në kontratë, është fjala për përgatitjen e sporteleve etj etj. U ceken dritat

ne Remnik, projekti për dritat ka qen prej lagjes se “Kuzulve” dhe dy degëzimet të përfundon elektrifikimi e ka perfundu punëkryesi dhe në mënyrë vullnetare këto të cilët i ka vendos edhe nja tri a katra nuk e di sigurt sa te poshtë, për shkak se ato janë kanë me mjete vetanake të qytetarëve dhe ato nuk kanë hi ne projekt i ka vendos në mënyrë vullnetare, kur dush ti bi edhe dokumentacionet, prandaj edhe vullnetarizmi është lejua gjithherë dhe nuk është problematike. Ato rrugë që i ceka janë ekzekutu me gyp, qashtu ishin kanë të parapamë me projekt e di që nuk e përbën ai cev, por qashtu ish kanë e parapamë, ndërsa çështja e qeljes se kanalit për bartjen e ujit nuk e kishe pas në kontratë. U ngrit çështja e punëtorëve pa rroga të pastrimit. Mund ndodh, këto kompanitë që po i marrin edhe mirëmbajtjen e jashtme të qytetit edhe në pajtohëm me se edhe në gjithherë e bej at trysnin shpeshherë ato punëtorët vinë tek unë, ankohen për vonesa të pagesës, unë shpeshherë ju kam thanë kompanive, nëse nuk ki pare mos e merr bre tenderin që mos me mujt me i mbulu punëtorët. U ngrit çështja të restaurant “Lindi”, edhe unë e shoh që është pengës, nuk e kemi bë zgjedhjen deri tash, besoj që duhet mu bë zgjedhje, është e arsyeshme, nxemjen në shkollën e Gushicës edhe kjo ka mu bë, e kemi gjet Gushicen me një gjendje pa rrugë, pa rrugën kryesore, pa kanalizim etj etj, kanë arrit krej mu bë dhe kemi ardh tash te një nxemje, besoj dhe shpresoj që edhe asaj do ti bëhet zgjidhje, por në relacion me lokalitetet tjera është investu shumë, është një prej lokaliteteve që në periudhën 5 vjeçare është investu me se shumti po edhe ju keni qenë aktiv si komunitet i Gushices ka qen aktiv. Uji i pijshëm, e kemi këtë gjendje që e kemi, unë e kam pas një takim, e kemi ngrit si çështje, jemi tu bë përpjekje maksimale me bë zgjidhje. Trotuari ne Pozharan-Viti, ka qenë projekt dyvjeçar, kryhet brenda këtij viti, kompanitë e pandërgjegjshme po i bin vetëm Pozharanit nuk pajtohëm me këtë, po bëjmë përpjekje me i përmirësu çdo ditë. Te çështja e stadiumit, ka qenë një defekt tjetër. Kryesuesi është në rrjedha, kemi bë përpjekje, me mu kujtoj që i kemi pas 4 takime të cilët në fund shumë na ka premtu dhe çdo javë unë e thirri ne tel drejtorin e sporteve, Iber Alen dhe më ka thanë, e ka përgatit edhe kontratën, veç po prit momentin ministri me ja nënshkru, ku kemi me shku edhe ne me e nënshkru me i vazhdu punët tjetra që janë të parapamë me kontratë. Edhe rruga në Sllatinë të Epërme nuk është 6 metra, është 5.5 kjo mu bë dhe pse nuk po vazhdojnë punimet për shkak se edhe kushtet në dimër nuk shtrohet asfalt, duhet tash kur të nxehet koha. Rruga “Hasan Prishtina”, me siguri e pate për këtë rrugën në qendër, e përmende që kemi premtu që 5 vite tretuar, nuk ma merr mendja, sepse mu pas premtu që 5 vite e kishin denu elektorati ne mandatin e dyte. Nuk po konsideron kjo, po megjithatë unë besoj dhe shpresoj që edhe ajo rrugë do ta këtë trotuarin e vet. Rruga pa emër, pa kanalizim, do ta shikojmë se ku është në Drobesh, për pa emër u kanë komisioni në mandatin e parë, të gjitha ato rrugë të cilat kanë meritin në kriter të cilën e kanë parapa ato kanë marr edhe emërtimin e vet, prandaj mund të ndodhë që tash ndonjë lagje mundet të plotëson kriteret, do ta këtë edhe emrin edhe çështjen e kanalizimit do ta shofim me siguri të koka lagje e re.

z.Taulant Haxhiu: Nënkryetar, unë i ceka emrat, kur i ceka dy emra për shkak se dytë janë bashkëfshatar të kryetarit. Njeri ligjëron, nuk e di se ne sa fakultete dhe tjetri i ka gogjo punët mirë. Ka pas edhe njerëz të tjerë për vende të punës, po kryetari i ka marr krejt të vet. A e ka vetëm Beguncën apo ka edhe fshatra të tjerë, dhe kërkoj që tash me ditë në 2019, sa janë tashti aktiv. E morra edhe informatën për urën. Unë po e shoh këtu, që kjo urë deri në fund do të kushton 219 mijë e 904 euro. Unë e di që një urë në Binq është rregullu me 30 mijë euro, është pak me e madhe, hajde po shikojmë 60 mijë, ama me kushtu 219 mije e 904 euro po me doket shumë, mirëpo unë për këtë ka me bë një verifikim me ekspertë privat, edhe po du një përgjigje nga drejtori ProEkoGrup, kush është pronar i kësaj kompanie, i cili e ka kry këtë pune.

z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar këshilltar komunal! Pat shumë pyetje për drejtorinë time, për disa u përgjigj kryetari i komunës. Rehabilitimi i rrugës Viti-Lernice, është projekt i Ministrisë së Infrastrukturës me komplet buxhetin, komuna nuk ka participim. Monitorimin, pranimin teknik, të gjitha ato procedura i udhëheq Ministria e Infrastrukturës. Me thanë të drejtën hala nuk kam dosje, nuk e di a është bë pranimi teknik për këtë rrugë. U ceken kontratat me shërbime të veçanta, informatën ju sjella, janë punëtorët që kanë punuar në vitin

2018, se edhe kërkesa ka qenë për të gjithë ata që kanë punu me kontrata me shërbime të veçanta, kurse për vitin 2019 i kemi hap konkurset, për momentin nuk e di nr. e saktë sa janë, mirëpo disa punëtor që janë në këtë listë kanë të bëjnë me disa projekte që i paguan punëtorët në Zyrën për Investime dhe ata punëtorë nuk i kemi pagu me buxhet komunal ose nga Helvetas, Demos, Bashkimi Evropian etj etj, po kryesisht buxheti alokohet tek ne dhe për këtë këta punëtor figurojnë tek ne dhe ne duhet patjetër me qit në listë. Ujësjiellësi Germovë, Gushicë. Ju e keni miratu, buxheti është, pozicioni për ujësjiellës kur u miratu buxheti, kryesisht është planifiku për rregullimin në Germovë-Gushicë. E keni ne raportin e investimeve kapitale. Rruga Sllatinë e Epërme-Dardani është në proces, mjetet financiare janë të siguruara dhe aneks marrëveshjen kemi me e nënshkru besoj javën e ardhshme, mjetet janë siguru nga Ministria e Infrastrukturës dhe me përmasimin e kushteve atmosferike kjo rrugë do të rregullohet, po si që tha nënkryetari projekti është 5.5 metra.

Drejtoresha znj.Majlinda Ostrogllava: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Pata një pyetje nga Bekimi, është e vërtet që vërejtja ndaj punëtorit ekziston në Zyrën e Personelit, vërejtja nuk është terjek, po ka qenë keqkuptim për shkak se personeli ja ka miratu pushimin vjetor. Unë nuk kam qenë në dijeni për këtë dhe e kemi arrit një mirëkuptim dhe kurrkush nuk me ka bë problem, as kryetari apo askush, gjithçka është në rregull.

Drejtori z.Basri Aliu: Përhëndetje të nderuar të pranishëm! Fakt që Ministria e Shëndetësisë ka shpall gjendje gripore, ndërsa ne si Drejtori e Shëndetësi dhe Mirëqenies Sociale, së bashku me Qendrën e Mjekësisë Familjare, kemi marr hapa të cilët naj ka marr mendja për me e tejkalu këtë gjendje sa me lehtë, kështu që, është njoftu stafi shëndetësor lidhje me gjendjen të cilën ndodhemi, që të jenë ata çdoherë ne gjendje gatishmërie, madje kemi marr hapa të tjerë, e kemi shtu numrin e punëtorëve në emërgjencë, që me ju ardh qytetarëve në ndihmë dhe me marr shërbime sa më të mira shëndetësore. Kemi rekomandu DKA-në, që të njoftohet personeli lidhur me gjendjen gripoze e cila ndodhet në Kosovë, kemi bë vizita ne çerdhe të fëmijëve, ka qenë një ekip mjekësor, kemi bë edhe furnizim të mjaftueshëm me barna, ato që janë me esenciale. E falënderoj stafin shëndetësor për punën që po e kryen edhe pse këto ditë janë tepër të ngarkuar.

Drejtori z.Milot Lala: Faleminderit kryesues, përhëndetje të nderuar të pranishëm! Patëm një pyetje rreth stadiumit sintetik. Unë dje kam qenë në takim me mbikëqyrësin e stadiumit. Është në fazën përfundimtare të punimeve, gjë që pritet të Dielen mu dorëzu edhe qelsat e stadiumit. Kështu që, do jemi kontakt me FFK-në, ku do ta organizojmë edhe hapjen solemne. Sa i për këtë buxhetimit, 120 mije kanë qenë nga FFK-ja, 100 mijë nga ministria dhe 30 mijë nga Komuna e Vitisë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Ne KPF janë diskutu të gjitha pikat, po kanë qenë dy çështje që janë dashtë mu kry. Në përputhje me kërkesat e këshilltarëve i kemi kry, njëra është që me sjell një historik të shkurtër për Komunën e Kroacisë, Velika Pisanicës, të cilën historik e kemi sjell; dhe nën dy, ka qenë për fshatin Navosellë, të cilën e keni kërku jo si tërësi me ardh po me nda, që është fjala për ngritjen e objektit fetar, gjegjësisht xhamisë, me ju definu parcela. Tash javë shpërndan sekretaria e Kuvendit.

Kryesuesi z.Naim Pira: I falënderoj të gjithë. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për mbledhjen e dytë të Kuvendit Komunal kemi parapare këtë:

R e n d d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt e KK-Vitisë
2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2018
3. a) Nisma e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.
b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në

nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.

c) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.

4. Propozim për ndryshimin e vendimit Nr.01-410/03-71 i datës: 08.02.2018 të KKSB-së me kërkesën e Forcës së Sigurisë së Kosovës.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të komunës Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti.
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores kushtuar dëshmorit Safet Rexhepi nga Zhitia.
8. a) Nisma e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Kirrhain-Gjermani në kuadër të axhendes së OKB-së për vitin 2020-2030.
b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Kirrhain-Gjermani në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.
c) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Kirrhain-Gjermani në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.

A ka dikush rreth rendit të ditës, pasi që nuk ka e qes ne votim me ngritje dore konstatoj që me votat e të gjithëve u miratu rendit i ditës.

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e rregullt e KK-Vitisë

Kryesuesi z.Naim Pira: Hap debat rrethe procesverbalit, a ka dikush ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim? E hedh në votim procesverbalin. Me votat e të gjithëve u miratua procesverbali.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Pasqyrat Financiare të buxhetit Komunal për periudhën janar-dhjetor 2018

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderur të pranishëm! Si zakonisht, çdo tre muj dhe në fund të vitit pasqyrat përmbledhëse financiare që kane të bëjmë me vit fiskal, është fjala për vitin 2018. Kemi për obligim ligjore t'i prezantojmë dhe t'i analizojmë se bashku me juve këtu ne kuvend. Materialin e keni marr me kohë, jam në dispozicionin e juaj për pyetje shtesë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

z.Ali Bajrami: Përshëndetej për të gjithë të pranishmit! Sa i përket pasqyrave financiare për periudhën kohore janar-dhjetor 2018, kemi të gjitha ato që i kemi votuar bazë Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe mbi Ligjin e Financave Publike ne nivel të Republikës së Kosovës. Mjetet e alokuara dhe mjetet e shpenzuara, nëse ndalim e shohim përqindjen është një përqindje shume e mirë, se këto mjete i kemi të shpenzuar me përqindje 99.49% për periudhën kohore janar-dhjetor 2018. Kategorinë e shpenzuara të buxhetit i kemi për paga, shërbime dhe mallra komunal, subvencione dhe kapitale. Nëse ndalim e shohim vitin paraparak 2017 me 2018, subvencionet që kanë qenë, jo në këtë përqindje të shpenzimit në 2018 i kemi 99.48%, që d.m.th janë shpenzuar në mënyrë shume të mirë shpenzimet për të gjitha njësit buxhetore. Nuk do të ndalem ne të gjitha kodet, po vetëm te kodet 13-230 shpenzimet e mbeturinave 16870 euro. Është një shumë që është shpenzuar pikërisht se vitit 2018 ka qen vit i shpallur nga kryetari për mbrojtën nga ambienti. A ka pas nevojë më tepër ka pas, por edhe kjo shumë është

përdor e ku Vitin dhe lokalitetet e Komunës së Vitisë janë në gjendje shume të mirë, pikërisht tu i falenderu investimeve dhe punëve që janë bërë në këtë lëmi. Kodi 13-410, shërbime në arsim dhe trajnime 6075 euro, edhe këto janë shpenzu për ngritjen e cilësisë të arsimit në nivel të komunës. Kodi 13-430, shërbime të ndryshme shëndetësore, është një vlerë shumë e madhe, 95 mijë 18 euro që kanë hy në shërbim për shëndetin e qytetarëve dhe efikasitetin në mbrojtjen e qytetarëve të komunës. Kodi 13-640, furnizime mjekësore 44 mijë e 828 euro. Nëse ndalim, e shikomi prej Zyrës së Kryetarit e të gjitha drejtoritë, buxheti i shpenzuar nga ajo që ne e kemi votu për periudhën janar dhjetor 2018, në të gjitha drejtoritë dhe në Zyrën e Kryetarit është mbi 99%, d.m.th një buxhet i menaxhuar dhe i shpenzuar shume mire. Ajo çka vlen të përmendet të investimet kapitale, vlera 2 milion e 182 mijë euro, është 98, 32 %. Ato çka i kemi planifiku i kemi shfrytëzuar dhe i kemi investu në bazë të nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Nëse i himë në strukturë të këtyre investimeve kapitale, 22% e kemi që ka shku në infrastrukturë rrugore, pjesa tjetër 78% ka shku në mirëmbajtje të objekteve shkollore. Arsim, Shëndetësia, ujësjellës, kanalizim, janë të përfshira të gjitha sferat që kanë qenë me interes dhe në dobi të qytetarëve. Marr në tërësi është bërë një punë e mirë, një punë e përgjegjshme dhe i ftoj të gjithë ata që kanë dhënë kontribut në kryerjen e këtyre punëve dhe investimeve. Njëherë i falënderoj edhe këshilltarët që e kanë dhënë kontributin dhe kemi një punë at që e kemi për vitin kalendarik janar-dhjetor për vitin 2018.

z.Nijazi Isaku: I nderuari kryesues, nënkryetar, menagjment, media, të nderuar të pranishëm, sa i përket raportit të pasqyrat financiare për vitin 2018, si raport është i rëndësishëm së veçantë, për arsyeje se shpalosen të gjitha shpenzimet brenda viti, si dhe është argument i fuqishëm për neve si asamblesita që kur flasim për qeverisjen apo keq-qeverisjen e kemi me të lehtë argumentimin se si po shpenzohet paraja publike. Duke analizuar këtë raport vjetor ne si VV kemi të njëjta shqetësime si i kemi ngritur edhe në vitin e kaluar lidhur me disa vija buxhetore si është shpenzuar paraja publike. Andaj, kemi konstatuar si; Paaftësi në mbledhjen e të hyrave; Shpenzime të tepëra luksi; Mungesë të transparencës së plotë për shpenzimin e parasë publike.

Sa u përket të hyrave vetanake për vitin 2018 gjatë kësaj periudhe janë inkasuar 791,991.25 euro duke u bazuar në planifikimin vjetor është 75,64% kur krahason periudhën e njëjtë për vitin paraparak 2017 të hyrat për këtë vit janë më të larta për 24.064,03 euro. Por si krahasim me vitin 2017 del me rritje, mirëpo dihet se viti 2017 sa i përket të hyrave ka qenë shume i dobët minus 186,632.00 mijë euro si planifikim andaj është referencë e dobët e vitit 2017 sa i përket të hyrave në krahasim me vitin 2016. Po ashtu, kur e shikon pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018, për të gjitha njësit buxhetore e posaçërisht të disa vija buxhetore vëren një shpenzim shumë të madhe të parasë publike. Po ndalemi të disa vija buxhetore: shpenzimet e udhëtimeve zyrtar jashtë vendit 10.163,31 euro - shpenzimet e udhëtimit brenda vendit në vlerë prej 17.065,04 mijë euro, mëditjet e udhëtimit jashtë vendit vlera 2.910,92 euro, akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit vlera 315 euro, shpenzime tjera të udhëtimit jashtë vendit 1,332.01 euro, - Dreka zyrtare 27.163.58 euro, Dreka zyrtare jashtë vendit 146,02 euro. Këto janë shpenzime luksi. Për të vërtetuar atë që ne kemi konstatuar për këto shpenzime po i marri disa shembuj çka kanë ngrënë këta pushtetar. Kemi tri Lajme në kallxo.com.

Zyrtarët e Komunës së Vitisë, në listën e ushqimeve të preferuara, përveç flisë dhe bakllavës po del ta kenë edhe menynë e mishit të kombinuar. Në faturat e drekave dhe darkave zyrtare, të siguruar nga KALLXO.com, komunarët e Vitisë kanë ngrënë 982 porcione mishra të kombinuar. KALLXO.com ka analizuar 18 fatura, në të cilat është porositur mish i kombinuar dhe llogaritë kanë dhënë numrin e 982 porcioneve apo 4 mijë e 520 euro vetëm për porcione të mishrave të kombinuar. Mirëpo, ka edhe fatura të tjera të cilat po ashtu kanë vlera të larta të shpenzimeve por nuk specifikohet se për çfarë ushqimi bëhet fjalë, në faturë figuron vetëm togfjalëshi 'ushqim+pije'. Sasinë më të madhe të mishin komunarët e Vitisë e kanë ngrënë në darkën e organizuar për Flakadanin e Karadakut. Manifestimi i cili në Komunën e Vitisë zgjati 3 ditë përfshiu 3 darka 'gjjigande'. Darka e parë më 24 mars 2018 së bashku me pijet kushtoi 1150 euro dhe u hëngrën 230 mishra të kombinuar të cilët kushtuan 920 euro. Ndërsa dy ditë më vonë 26 mars 2018, 'apetit' për mish të kombinuar u rritë edhe më shumë, komunarët e Vitisë hëngrën 391 mishra të kombinuar në vlerë 1564 euro, Ndërsa në darkën e tretë pati 'rënie' të lehtë të appetitit, gjatë kësaj darke, janë ngrënë 244 mishra të kombinuar të cilët kanë kushtuar 976 euro e duke i llogaritur edhe pijet, vlera e kësaj fature ka shkruar në 1220 euro. Përveç mishit në këto drekat dhe darkat zyrtare të komunës sonë nuk mungojnë edhe ushqimet tradicionale shqiptare të cilat janë porositur nga zyrtarët e komunës dhe paguar nga buxheti i komunës. Gjithashtu, pas mishit dhe filave nuk kanë munguar as pijet

alkoolike si birrat dhe vera, të paguar nga buxheti komunal. Krejt këto fakte janë të publikuar në portalin kallxo.com. (Këto fakte i kemi me vete). Unë i kame nxjerr të gjitha këto ne kallxo.com qysh i kanë publiku ata i kemi 18 fatura janar-mars-shkurt, dhjetor, janar, janar, shtator etj etj, të cilat janë të publikuara. Si shpenzim tjetër interesant që e hasim te të gjitha drejtoritë dhe Zyra e Kryetarit është vija buxhetore – Shërbimet kontraktuese tjera, që kapin vlerën prej 108,927.27 mije euro, e të cilat tani po dihen se bëhet fjalë për punëtorët me kontrate mbi vepër, e që “Auditori i Jashtëm e kishte cekur si e gjetur në raport për vitin 2017, në komunë ishin angazhuar 90 punëtorë. Ku për vitin 2017 ka qene mbi 100 mije euro të shpenzuar për këtë vije buxhetore. Edhe në këtë vit 2018 është i njëjti avaz i shpenzimit te kjo vij buxhetore. Që nënkupton edhe këtë vit po vazhdohet me kontratat mbi vepër apo me afate të caktuar.

Vija buxhetore – mirëmbajtje dhe riparim i automjeteve 29,673.00 mije euro për vitin 2018, kur krahason me vitin 2017 te kjo vije janë shpenzuar 26,042.00 mije euro, si është e mundur që 29 mije euro u shpenzuan për vitin 2018 për mirëmbajtje të automjeteve. Ky është keqpërdorim tipik i parasë publike. Këtu mendoj që ka qenë dashur me një plan tjetër, ndoshta kishte me qenë më mirë me i ble veturat e reja kur kemi parasysh se ne vitin 2017 janë harxhu 26,042.00 mije euro. Viti 2018 janë harxhu në mirëmbajtje të veturave 26 mije bane një strategji që se paku për vitin 2019 vleni vetura të reja.

Zyra e Kryetarit, si shpenzime dhe mëditje jashtë vendit 6.200 euro, cili është rezultati i këtyre vizitave. Ku kemi një rëne drastike të hyrave nga donacionet në vlerë 67,516.50 mije euro për vitin 2018, në krahasim me vitin 2017 është minus 117,160.42 mijë euro. Ndërsa, te vija buxhetore - shërbimet e varrimit kodi 13490 janë paguar 1,120.00 euro, ku obligohet komuna me rregullore të aprovuar nga Kuvendi Komunal që t’i bëjë pagesa për shërbimet e varrimit, ku deri tani si borxh ndaj Bashkësisë Islame arrin shifrën 19,110.00 mije euro.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kemi diskutuar edhe në KPF, do të jem më i shkurt ne diskutim. Më intereson shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, janë dikun komplet 15 mijë euro, a ka mundësi ne cilat vende në cilët shtete janë këto udhëtime. Te shërbimet kontraktuese tjera, e kemi edhe listën bazë emrave, kush janë pagu. Ne e dimi që me kontrata me shërbime të veçanta, mund të jete dy herë nga tre muaj që mund të angazhohen, ndërsa ketu kemi edhe me nga 10 muaj që janë angazhu edhe 11 e 12 muaj edhe kemi 13 muaj. Një rast njëherë te administrata e përgjithshme që naj ke pru me mbiemrin Behluli, gjashtë muaj ka 365 euro 2136 euro. Në Drejtori të Arsimit i njëjti person që i kemi shënimet është 365 euro, here 4 muaj pluse 350 euro here 3 muaj tashi totali 4+3+6, janë 13 muaj që është pagu me shërbime të veçanta. Unë po flas bazuar ne këtë informatë që e ke sjell ti. U tha që është shpenzu buxheti 98%, po qysh nuk shpenzohet kur gjykata ti merr mbi 100 mije euro, kjo është një shqetësim që gjykata është tu mbledh pare në komunë, po ka me mbledh edhe me shume, sepse projektet nuk kryhet mirë, sepse bëhen manipulime, sidomos siç ka qenë kanalizimi i Smirës dhe i Terpezes, kur e dimi mbi 100 mije euro të mjeteve të zotuara të kanalizimet janë marr prej mjeteve të zotuara dhe janë shku në projekte të tjera. Projektet nuk janë kry, nuk janë pranu. Projekti i Terpezes përmes përmbaruesit ja ka marr 70 mijë euro e kështu me radh, po mbi 100 mijë euro i ke që tu kanë marr nga gjykatat, është shqetësuese kjo. Edhe 40 mije euro shpenzime derivate edhe kjo është shqetësim. Llogaritne, 40 mije euro, shtinja lapësin e shehni sa duhet me nejt kerret dhezë, mirëpo nëse krahasohet me vitin e kaluar, atëherë ka qenë 50 mije euro, po atëherë ka qenë edhe fushat dhe tregon që në fushat ka pas edhe më shumë shpenzime. Nëse krahasomi këtë vit me at që shkoj, vetëm shpenzime të derivateve të kryetarit janë 1500 euro, që me i llogarit me ditë pune nuk i bjen shumë që ka bë shpenzime ose janë minimale, mirëpo kur ti llogarit me vitin e kaluar, që ka qenë fushatë, kanë qenë 5 fish më të mëdhaja. Llogaritne vitin e fushatës që i ka harxhu karburant kryetari, i bien dikun 5 orë në ditë kerri dhez me njëjtë gjate 24 orëve, ndërsa këtë vit e ka me pak. Pse? Sepse, këtë vit shume ka nejt ne Zvicër, nuk ka pas mundësi me i shpenzu këto derivate. Te kontrata me KARITAS-in, nuk është shumë e definuar, besoj që na jep informata më shumë, 94 mijë e 300 euro, kodi 13430. Qetu kam nevojë për një sqarim me detaj. Te sektori për ekonomi dhe zhvillim. Një projekt që thotë, zgjerimi i rrugës Drobesh-Mugillë, qetu nuk po muj me e gjetë ku është ky zgjerim, ku është kjo rrugë, s’unë po e gjej këtë rrugë.

z. Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Tek të hyrat e pa arkëtuara, deri në vitin 31.12.2018, po shihet që janë 2 milion e 12 mijë euro, është kogjo vlerë e madhe. Nëse ishin kthy, këto në investime kapitale, a i keni bë planifikimet se qysh me i nxjerr këto para, sepse këto duhet me ju kthy qytetarit. Statistikat i kam kërku kogjo shumë herë, edhe ka me i kërku vazhdimisht statistikat për investime që behet në çdo vendbanim. Pse nuk i nxerrni këto statistika. Po kërkoj prej teje që ti nxerrni këto statistika.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje për të gjithë. Tek faqja 24 dhe 25, ku thuhet prezentimi analitik i investimeve ne periudhën janar - dhjetor 2018, është kodi 14, asfaltimi i rrugëve rurale “Rahovica Comerc” Smirë, Kabash, Podgorc, Goshice, Beguncë, Drobesh, Qifllak. Në Smirë nuk e di që është shtru ndonjë rrugë me asfalt, edhe te kodi 23, asfaltimi i rrugëve rurale “Zuka Comerc”, edhe këtu figuron Smira. Unë nuk e di që janë shtru rrugë ne Smirë. Faqe 24, rregullimi i kanalizimit dhe gropave septike. Edhe këtu figuron Smira. Unë nuk e di që është rregullu ndonjë gropë septike në Smire, as që është intervenu në kanalizimin e Smirës. Faqe 25, mbikëqyrja e projekteve PMN SHPK, që e kemi vlerën 6669 euro dhe prapë e kemi mbikëqyrjen e projekteve ING ideja 2566 euro, që të dyja e kapin një shumë prej 9235 euro. Për një vit jepen për mbikëqyrjen e projekteve, ndërsa projektet në komunën tonë për vitin 2018. Shumica prej tyre nuk e di a ka kalu ndonjë që ka pranimit teknik. Kjo është shumë serioze për mu.

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Parafolësi im Nijazia, me pëlqej kur e beri një elaborim të inkasimit për vitin 2017, tu e ditë që karshi planifikimit vërtet ka qenë jo e lehtë dhe tash kur e merr e krahason arritjen, e targeti të 2018 të raport me 2017, prapë jemi keq. Nëse ato vlera i krahasojmë, d.m.th kemi një rritje 24 mijë e 640 euro. Po në krahasime minusin 186 mijë në 2017, nuk është performanc e mirë, këtë e dinë edhe drejtori i Financave. Kemi disa shpenzime që për mu nuk janë të arsyeshme dhe norma që do ti bëj do pyetje, vija buxhetore 11126 OMK është një shpenzim 1365 euro. Vitin e kaluar nuk ka qenë ky pozicion, u shtu këtë vit, pastaj shpenzimet e udhëtimit brenda vendit 17 mijë e 65 euro janë këtë vit, kurse në vitin 2017 kanë qenë 28 mijë e 658 euro. Është një dallim gati prej 11 mijë e 500 euro, d.m.th është shume me i ultë këtë vit. Një sqarim, pse ky dallim kaq i madh, është mirë që është ul, po pse, çka ka ndodh. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit. Këtë vit janë rrit për 5662 euro, një arsytim pse janë rrit dhe për çfarë qëllimi. Shpenzimet e telefonisë mobile, 18 mijë e 489 euro, janë rrit për 11 mijë nëse nuk jam gabim. Në krahasim me vitin 2017, kur e dimë që tash përdoren edhe mjetet e tjera të komunikimit. Shpenzimet e telefonisë fikse 9300 euro, shpenzimet për internet 1600 euro. Faqe nr. 4, furnizimi me ushqim dhe pije. Këtu janë nda, se realisht ishin dikun 27 mijë 163 euro, krahasu me vitin e kaluar, 38 mijë e 19 euro. Është një rënie këtu, mirëpo, po besoj që kemi nevojë pak me bë shkurtime buxhetore. Sa i përket shpenzimeve me aktivitete, sidomos me dreka zyrtare dhe jashtë vendit. Te disa drejtori, te drekat zyrtare, kemi ngritje 100%, p.sh.: dreka zyrtare. Vitin e kaluar, Drejtoria për Buxhet dhe Financa ka pas dikun 450 euro, e sivjet ka 985 euro. Këto i vëreja edhe te disa drejtori të tjera. Te Drejtoria e Bujqësisë, unë kisha bë thirrje që të ndahet një buxhet më i madh. Sa i përket kësaj drejtorie, shpenzimet janë bë në rregull. Të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikura dhe të realizuara për periudhën Janar-Dhjetor 2018. Faqe 19, prapë kemi një planifikim jo të mirë, është mirë që të bëhet një planifikim me i detajuar, që mos të ndodhe. P.sh. dikun planifikojmë me e inkasu 10 mijë euro, e inkasojmë 500 euro. Lejet ndërtimi janë realizuar vetëm 36%, lejet mjedisore 0%. A janë mirë të planifikuara lejet mjedisore dhe leje e përdorimit, apo ndoshta nuk janë të aplikueshme fare. Masi janë zero zero, d.m.th realizimi karshi planifikimit është zero zero. Kemi një planifikim te dënimet e gjobave të gjykatësve, janë planifiku mu bë dënimet 119 mijë e 375, kurse realizimi është be 1.65%. Është një planifikim i dështuar. Sa i përket totalit të donacioneve, ka pas përpjekje prej kryetarit, bukur shumë takime, udhëtime zyrtare jashtë, me donacione jemi keq në raport me vitin 2017, totali i donacioneve është 67 mijë euro, kurse vitin e kaluar ka qenë 184 mijë e 676, përpjekje ka pas po realizimi jo. I mirë krahasimi i të hyrave vetanake në periudhën janar-dhjetor 2018 me te njëjtën periudhe 2017. Nëse e merr këtë tabelë edhe e sheh, këtu kemi pas gjashë pozicione, kemi planifikim të qëlluar. Planifikimi në të shumtën e pozicioneve është minus. Periudhën janar dhjetor 2018 janë realizuar të hyrat me të larta, 24 mijë 64 euro ne krahasim me 2017, mirëpo ne nuk duhet të jemi të kënaqur me këtë performancë, sepse e dimë të gjithë. Në faqe 23, prezantimi analitik i investimeve për periudhën janar-dhjetor 2018, janë ofru krejt emrat e firmave, përshkrimi i investimeve, vendi i investimeve, fondi burimor edhe kërkesën që herën tjetër me e cek, që firma prej cilit lokacion vinë, megjithatë që kanë drejt me ardh prej tërë Kosovës. Faqe 26, te paraqitja grafike e investimeve, sipas burimeve të financimit për periudhën janar dhjetor 2018. Kur e krahasojmë përqindjen e të hyrave vetanake me buxhet, vitin e kaluar kemi pas dikun që te hyrat vetanake kanë pas një participim 24.36%, kurse këtë vit me 17.76%, dhe kur e krahason tash inkasimin që ka qenë me i lartë, 24 mijë, i bjen pak në kundërthënie. Kjo ka qenë dash me qenë përqindja më e lartë. Të hyrat e pa arkëtuara, drejtor, sa i përket të hyrave te paarkëtuara të tatimi në pronë, kjo është në krejt Kosovën pak a shume e njëjtë, se kemi probleme me tatimin në pronë, po ashtu te taksat e bizneseve janë të pezulluara, mirëpo unë nuk pajtoj te shfrytëzimi i

hapësirave publike dhe te qiraja e hapësirave publike të kemi borxhe të painkasuara. Këtu duhet mu bë një presion. Gjithë ata që kanë hapësira publike, toka edhe lokale. Këto duhet të inkasohen.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Kur na keni raportu drejtor në shtatore për TM3, pate shpreh skepticizëm edhe pse ka hy ne fuqi Ligji për Procedurat për Përmbartes Privat. Po si duket kjo nuk është paraqit edhe në shifra, sepse po shihet që të hyrat e planifikuara me ato të realizuara nuk janë me një trend progresiv. Nëse e marrim si shifër e e krahasojmë atëherë jemi me përqindje të barabartë sikurse ne vitin 2015, ku kanë qenë të planifikuara 1800 euro, janë arkëtuar 781 mijë euro, d.m.th 77%, kurse tash jemi 75%. D.m.th në fakt ka ramje. Ajo çka është shqetësuese, kam shikuar po ashtu edhe në tryezën që e keni pas të përbashkët me Ministrin e Financave, vërejtja kryesore është dhënë, që inkasimi i të hyrave vetanake është në nivel të ulët dhe posaçërisht e ka vnu theksin që niveli është jo i kënaqshëm. Tash, nëse krahasohen të hyrat vetanake, d.m.th nuk u rrit ai niveli i kënaqshëm, edhe kam bë një analizë grandit qeveritar, tu fillu nga viti 2014. Këtu ka qen 1 milion e 900 mijë euro për me vazhdu ne 2015 1 milion e 600 mijë, në 2016 1 milion e 100 mijë, 2017 1 milion e 113 mijë, d.m.th komplet po pëson ramje. Si do të mbulohet kjo hapësirë, edhe ju keni qenë skeptik, keni bë një plan operacional, mirëpo kjo po shihet që nuk po jep rezultate. Raporti, krejt çka mundem me fol është për 20% të këtyre parave, për arsye se 80% shkojnë paga mëditje eshte aty mundet ne me dhën edhe kritiken tone, drejtor në tre mujorin e fundit kur keni raportu në TM3 përqindja e ekzekutimit të buxhetit ka qenë 42%, d.m.th nuk e ka mrri shifrën as 50% dhe pikërisht vërejtjet që i ka dhënë edhe Lëvizja Vetëvendosje ka qenë pikërisht se fundi i vitit do të na gjen me shpenzim të shpejt të buxhetit, çka na u ka dhënë me shifra, ku nga 42% është rrit në 98%, shpenzimet gjithashtu ne TM3 vërehet te Zyra e Kryetarit, te kodi buxhetor, p.sh.: 13430 shërbimet e ndryshme shëndetësore, vlera 15 mijë euro ne TM4 menjëherë kemi 10 mijë euro me tepër. U tha shumë që kryetari ka udhëtuar jashtë, e tregojnë edhe shifrat. Nuk po konvertohet në donacione, është premtu shumë po me shifra nuk qëndrojnë mirë, pikërisht i kemi vetëm 67 mijë euro donacione. Prapë kemi një trend të vendimeve gjyqësore, po prezantohen në vazhdimësi edhe në 2017, ka pas edhe 2018. Këto nuk planifikohen, këto merren nga zërat tjera buxhetor e po ashtu edhe komuna mbetet keq edhe sipas Ligjit të Financave Publike, neni 46, jeni i obliguar me na prezantu edhe numrin e saktë të punëtorëve dhe po ashtu ata të cilët janë të përkohshëm, po ashtu edhe ata të cilët janë, d.m.th të përhershëm. 18 mijë e 489 euro është perime shumë. Telefoni mobil, edhe le ta dinë qytetarët e Vitisë, se nuk është pa pare me fol, sidomos na qe jemi në rrjet, Arsimi, Shëndetësia e Administrata, po paguhen prej taksave te qytetarëve. Më intereson te kodi 13430, te përkujdesja shtëpiake. KARITAS-i këtë shifrën 94 mijë e 300 janë pagu se ju keni pas një kontratë me KARITAS-in, d.m.th janë pagu punëtorët nga kjo. Te pagesa e komisioneve, prapë kemi 13460, 1513 euro, cilët komisione janë paguar, a janë këto ne kuadër te Kuvendit që i kemi, pajisje trafiku, furnizime me shenja dhe vija te komunikacionit 15 mijë e 39 euro, sinqerisht nëse i sheh shenjat e komunikacionit gjithandej janë të dëmtuara, janë të larguara. Kam kërkuar jo me pak se tri vite ne rrugën përball shkollës, në Skifteraj, të bëhet zebat, të jepet sinjali që ka shkollë, sepse aty fëmijët, sidomos ata parashkollor dhe cikli i ulët, janë të rrezikuar. 15 mijë euro janë shpenzu prej buxhetit. Kjo kërkesë nuk është marr parasysh. Furnizim me topa futbollit nëpër shkolla 4662 euro. Këto do të fillojnë në shtator, shkollat do të furnizohen, një paralogaritje shume e thjesht, 4662 euro i pjesëtojmë me 6 euro, se 6 euro është çmimi i shumicës i topit te futbollit, del që janë pagu 777 topa, tu i pjestu për 21 shkolla nga 37 topa për çdo shkollë. Po shkollat nuk janë të furnizuar, nuk ka pasi që vet jam në proces edukativo-arsimor, qyshe në shtator kemi bë kërkesë, asnjëherë nuk kemi mundësi me e zhvillu çoftë një lojë të volejbollit, basketbollit. Duhet ta kuptoni, që kjo është material shpenzues, njëjtë si është shkumësi, ashtu është edhe topi, ani pse është rekrziv sportiv, kjo është material shpenzues. Parashihet, u parapa në plan të prokurimit, po fakti, realiteti qëndron tjetër. Te mirëmbajtja e rrugëve, qekjo shuma 63 mijë e 399 euro a është pagu projekti i rrugës “Hasan Prishtia” prej qeti kodi buxhetor, pasi që aty njëherë naj mbush gropat po pas një jave janë kthy e kane grry at asfalt që e kanë shtru. Këto janë informatat të vërtetuara nga banoret të cilët jetojnë në atë rrugë dhe masanej është shtru. Po shqetësimin që e ngriti kolegu Jakup, është e saktë që ajo rrugë është jashtë standardëve, rruga është prishje e sipër, kualiteti i punëve është i dobët, plus është lartësia e atyre ujëmbjellësve të ujit, është me një lartësi të madhe, çka e ngarkon edhe trafikun. Te mirëmbajtja e mobileve dhe pajisjeve ne Administratë dhe Shëndetësi, çka keni mirëmbajt çoftë në Shëndetësi çoftë ne Administratë, a po prishen mobilet apo çka është në pyetje, është një shume kogji e madhe 6 mijë e 43 euro si dhe pyetjen e fundit e kemi tek shpenzimet për informim publik transmetimi ne tv 4933 euro jemi dëshmitar koleg asamblist se shumicën e kohës ani pse është parapa ne plan të prokurimit, nuk kemi pas media e kame pa që e keni një sport për tatimin

në pronë, po qekjo shume 4933 euro cili operator ekonomik është pagu apo cila eshte pagu, sepse sporti nuk kushton me shume se 120 euro.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sa i përket pikës që po diskutojmë, u thanë shumë nga parafolësit. Në faqe 4, është kodi 13503, bëhet fjalë për kompjuter 10 mijë e 276. Më intereson ta di, cilat njësi buxhetore janë të furnizuara me kompjuterë, pastaj është kodi 13509, pajisje të tjera, 58 mijë e 212, është një shumë e lart. Tek faqja 5, kodi 13450 shërbime, shtypje jo marketing 9729 ky kod, dhe kjo shumë nuk ka qenë e paraqitur në raportin financiar për periudhën janar-shtator që e kemi marr. Pastaj faqen 5, është kodi 13610, furnizim për zyre 7966. Nëse ka mundësi një sqarim, faqe 6, kodi 13430 shërbime të ndryshme shëndetësore. Kemi kërkuar sqarim nga Zyra e Personelit për pasqyrat financiare në muajin shtator dhe nuk kemi pas. Faqe 6, kodi 13611, furnizime me dokumente blanko, nga muaji shtator kemi rritje të shpenzimeve. Në muajin shtator shuma ka qenë 1500, kurse tash është 6907, pra është plus 5400 është rrit nr. i shpenzimeve. Nëse ka mundësi një sqarim. Faqe 9, kodi 13460, shërbime kontraktuese te tjera, 13771 euro, pastaj faqe 19 totali i gjeodezisë. Ekziston rregullorja e cila është aprovuar nga Kuvendi, i propozuar prej Drejtorisë së Urbanizmit. Si ka mundësi që inkasimi si për leje mjedisore, ashtu edhe për leje të përdorimit të jete zero. Gjithashtu është shqetësuese fakti, se qiraja nga hapësira publike është në shifër 22%, pra buxheti komunal është në minus. Po ashtu shitja e masës drunore është në një vlerë vetëm 20%, pra nga kjo tregon, se nuk ka planifikim adekuat. Në faqen 23, është renovimi i shkollave në Komunën e Vitisë. Në mesin e gjashtë emrave figuron edhe ajo e fshatit Drobesh. Unë me sa jam në dijeni, në fshatin Drobesh, përveç dyerve nuk ka pas ndonjë renovim, pra po tingëllon si shumë e madhe 27 mijë e 499 euro. Më intereson ta di, se a ka pasur edhe në shkollat e tjera renovim të tillë, apo diçka tjetër. U përmend edhe me herët, zgjerimi i rrugës Drobesh Mugillë. Kam kërkuar sqarim për këtë edhe me herët, por nuk kam marr sqarim, e prapë kërkoj sqarim për këtë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Është bisedu shumë për udhëtimet jashtë vendit dhe ja keni dhënë formulën, se rezultatet kanë mungu varet nga cili kënd e keni shiku dashtë e pa dashtë duhet ta pranojmë pese vite janë të qeverisjes, krejt shumën e udhëtimeve në botën e jashtme, qe muj me e grumbullu. Nuk e besoj që e kalon shume prej 40 mijë euro, por nëse doni rezultate kurrë asnjë cent ne asnjë mjet nuk e kemi ble. Te Njësitit i Zjarrfikësve, krejt janë donacion, krejt janë nga Zvicrra, krejt kanë ardh ato fal këtyre aktiviteteve. Në rast se ju nuk doni me e pa e ki shëtitore që është bashke participim i bashkatdhetarëve tone, vizitat që i ka bë kryetari, dhe një deponi që ka qen e bërllokut, me mijëra tonë të cilët janë jek. Sot e ki një shëtitore që e gëzojnë qytetarët jo vetëm shifrat të cilat po i numëroni 67 mijë edhe e ki vitin e pestë të cilët ndoshta për të mirë e ka marr e gjithë Kosova, të gjithë hallegjinjet kemi bë përpjekje, fal bashkatdhetarëve tanë që kurr shifra e tyre nuk ka qenë ner 5000 euro dhe krejt ajo shifër për pesë vjet e kalon dikun 25 mijë euro, mos të bisedojmë edhe shumë çështje të tjera të cilat kanë ardh. Krejt këto janë fal angazhimeve, por mos të harroj edhe një, a nuk e meritojnë ata bashkatdhetar që e kanë kalu shifrën mbi 60 shpi të ndërhuara të rasteve sociale, që janë të ndërhuara pikërisht nga ata, a mos me i respektu kanjeher mos me shku edhe ne vitit kur i kane ata festat e karakterit shtetëror, me krejt at kontribut të tyre. Unë konsideroj që po, prandaj duhet t'i shohim në këtë çështje dhe rezultatet i kemi evidente dhe e kemi një lëvizje të lokomotivës, të cilën nuk është me rendësi a do të jete Sokol Haliti a kush do të jete kryetar me gjithat është një lokomotivë e cila ka fillu me lëviz dhe është ne rruge se kush do të vjen mas Sokol Haliti e ka rrugën e trasume me formim të shoqatave te cilët kanë hi në lëvizje dhe po i ndihmojnë këtij vendi gjithherë, prandaj ndoshta ju sugjeroj këtë rast shini këto. E vizita jashtë vendit nuk nënkupton vetëm Zvicrën po edhe vende të tjera, e aty nuk është vetëm kryetari po edhe unë se bashku me kryesuesin kemi qen dy herë. Nijazi e ceku, mishin e kombinuar. Unë kur ta qoj tjetër herë delegacioni ka me ju than merrni bukë thatë, një këshilltar i kuvendit komunal me thanë kështu hajgare është kjo. Para një muaj dite e kemi pas qetu simpoziumin që ndoshta nuk u bë në nivel kombëtar për shkollën e parë shqipe në shekullin 16 dhe 20 dhe kanë qenë drejtorët e shkencës, jo vetëm nga Universiteti i Prishtinës, nga të gjitha viset shqiptare dhe kam qenë edhe unë aty se bashku me ta ne dark dhe unë nuk i kam thanë mos merr mish të kombinuar, as mos merr vin, edhe pse unë se përdori këtë, ata e kane marr, është çështje normale kjo dhe ti u sille një ore paska pij vinë. Duhet me qenë shumë fer, mani mos bëni hajgare. Ven me than, e përgëzoj Komunën e Vitisë që e ka zbarku krejt Universitet e viseve shqiptare, këtu është debatu për shkollën e parë shqipe dhe është me e falënderu atë iniciativë. Bisedojmë për Flakadanin e Karadakut, ku e dimë që ajo ka kalu në tradicional. Është festival mbar kombëtar, ajo paguhet, kallzo.com me i qit këto në gazeta.

z.Nijazi Isaku: Nënkrjetari tha për pese vite të qeverisë, na jemi tu diskutu pasqyrat njëvjetore dhe të fokusomi në këto pasqyra. Tash qasja juaj qyshe e keni me paranë publike, neve nuk ka doket normale me i hargju të gjitha ato para për ato dreka, nuk ke për Universitetin këtu, po ke për Flakadanin edhe për Flakadanin kurrkush nuk është kundër, po paramendo askush nuk ka marr çmime me të lira, po krejt mish të kombinuar. Ne mendojmë, që sa me shume duhet ta ruajmë paranë publike, Diaspora është duke investu me para të veta. Faturat që i ceka unë, fatmirësisht që kallx.com i ka publiku edhe ne po i marri e nuk hezitojmë me i qit nëse edhe një euro mujmë me arrit me mbrojt si asamblist i kuvendit komunal, paranë e qytetarit, unë ndihem krenar për krejt mandatin e jo për shumën e parave që ju e merrni me atë lluks, që është gjë normale me e shpenzu paren e qytetareve për gjë normale paguhesh e ki një kosto të caktuar, ne nuk kemi fol asnjë këtu për raportin, ku p.sh.: afër 8 milion që shpenzohen në paga, se e dimë që ato janë paga fikse, për këtë nuk po diskutojmë ne, po diskutojmë për pjesën tjetër, ku mundet mu ndal mu bë menaxhimi më i mirë. Pse mos me u bë menaxhimi më i mirë edhe ne riparim të veturave. Krejt këto po diskutohen për të mirën dhe për me e mbrojt buxhetin e komunës, po jo tash me shku me atë cinizmin që po flet ti për mish të kombinuar. Ideja është te qasja se qyshe ju qasni ju parasë publike, edhe na jemi për me mbrojt paranë publike.

Nënkrjetari z.Hasan Aliu: Unë nuk e kam problem Nijazi, përpjekjen tane pse po e bënë ti për me mbrojt paranë publike, se me më pyet mu, unë konsideroj se jam shumë më shumë se ti i dhënë me mbrojt paranë publike, po megjithatë këtu është një garë të cilët kanë qenë një ekip, i cili është sprovu për katër vite dhe qytetarët kanë thanë që qeta po e rujanë mirë me ja vazhdu edhe katër vite, prandaj duhet me pranë si të tillë. Tash qysh i qasesh ti, unë të kam thanë njëherë me sinqeritetin më të madh, po ta thamë edhe mos me pas bindjen unë ,se është qeveria shumë e përgjegjshme. Në këtë drejtim unë do të iki prej ekipit, po e kam bindjen se është shumë e përgjegjshme tash janë do çështje që nuk mundesh me i ik ajo paguhet atje e ka rrogën 1500 per me i qit qato fatura na ja japim ato nëse konsideron që është bë shkelje, është edhe një prokurori mas çdo auditimi e qon raportin dhe munden mu ngrit ajo çështje edhe të nivelit penal, e dikush edhe mu dënu. Në këtë kontest po të thamë, dhe ti masë një kohe ki me përjetu, këtë ki me pa qe kjo ka me dal qyshe të ka than Hasan Alia, se janë çështje që sun i ik. Nëse Komuna e Vitisë është komuna me shpenzime me të pakta ne nivel të Kosovës, nëse ti thu që kanë ra investimet, vitin e kaluar e ki pas me aparaturën më të mirë, donacion prej Zvicrës, që i shërben zjarrfikësit, e për me e pru këtë u kanë dashtë me shku me një vizitë edhe një herë komandanti me shku me ekip te vet e krejt ato janë shpenzime jashtë vendit.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përhëndetje! Pat shumë pyetje, po mundaohem të ju përgjigjem. Pasqyrat financiare, kush donë me i kuptu drejtë, janë elemente të natyrës që kanë ndodh për një periudhë të caktuar. Bazë e krejt këtyre pasqyrave është buxheti i miratuar ne shtator të vitit 2017, për vitin 2018 dhe tash ne vitin 2018 e kemi miratu për vitin 2019. Kur ta miraton Kuvendit Komunal buxhetin, ai është ligj për qeverinë komunale edhe ne duhet me punu bazë kësaj. Edhe unë po ju garantoj, që buxheti zbatohet përpikëri me at që ju e keni miratu dhe atë që e thotë Ligji mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe të gjitha ligjet e tjera pozitive, të gjitha kontrollet që i kemi pas edhe nga departamenti për krimet e rënda edhe nga auditori i jashtëm, auditori i brendshëm, nga prokuroria, asnjë element për gjykim nuk e kemi në këtë mandat, në kuptimin e saktësisë dhe të përgjegjësisë, të ekzekutimit të buxhetit, që janë miratu me votën e juaj. Drejtoria për Financa e zbaton buxhetin e juaj dhe ligjet që janë ne fuqi. Asnjë pozicion që është i parapamë ne buxhet nuk e kemi tejkalu, desh për reprezentacion, desh për mirëmbajtje të kerreve, desh për dreka zyrtare, udhëtime zyrtare. Pat shumë pyetje, kur të doni me dite saktësisht diçka, bëni pyetje me shkrim ose për seancën tjetër unë javë bi, bëne listën çka kërkoni, unë jav sjelli me të gjitha elementet. Te të hyrat vetanake, edhe unë thamë që duhet mu mbledh me shumë. U bë planifikimi jo i drejt ose realizimi jo i mjaftueshëm, kjo problematikë është ne nivel të Kosovës, planifikimi nuk është i drejtë, mirëpo planifikimin naj cakton Ministria e Financave, e cila thotë që Komuna e Vitisë ka mi mbledh 1 milion e 47 mijë, tash çka duhet me bë na si qeveri komunale, me thanë drejtën këtu ndoshta ju hi në hak edhe drejtorive komunale, sepse kur ta shpërndajmë na këtë buxhet, ndoshta sun e qëllojmë mjaftueshëm, që na del të një drejtori përqindja më e madhe, e dikun më e vogël, po ajo ku kemi bazë të shnosh është tatimi në pronë, qe e kemi evidencën e saktë dhe ku mujmë me e zbatu qind për qind ligjin. Ke një pyetje, a janë marr masat të tatimi në prone për rritje, se ka qenë përqindje e vogël. Nuk ka rritje, Ligji për Faljen e Borxheve, nuk ka koincistu me qëllimin e tij, nuk kanë ardh rezultatet që i kemi prit qytetarët, me qëllim apo pa qëllim, vetëm inkasimi nuk është rrit. Në marrëveshjen e përmbaruesin private e kemi në dikune ne dhjetor listët e 100 të parëve që kane borxhe me te madhe në Komunën e Vitisë, e kemi qu te përmbaruesi, të hyrat janë tu ardh, në 2019-të

listën tjetër prej 100 personave jemi duke e përgatitur. Çdo borxhli që ka borxh tek tatimi në pronë, që e kalon shumë prej 300 euro, dhe tre muj nuk e pagun at borxh në kemi të drejt me e qu te përmbaruesi privat. Nuk e bënë komuna këtë, Ministria e Financave pa na pyet neve e bënë këtë pune edhe shkon e masat e dhunshme, dijet cilat janë, edhe pse mu me vjen keq për këtë, po Ligji mbi Tatimin në Pronë e ne duhet ta zbatojmë këtë ligj, edhe unë pajtohem dhe nuk jam i kënaqë me te hyrat vetanake, po edhe ju si këshilltar mundeni me na ndihmu që ti rrisim të hyrat vetanake. Statistikat sipas vendbanimeve të investimeve kapitale ishte një pyetje. Buxheti nuk ndahet sipas fshatrave, po edhe shpenzimi i buxhetit dhe planifikimi për investime kapitale nuk planifikohet saktësisht me mbajt naj kontabilitet të veçantë për fshatrat veç e veç. Kontabiliteti është unikat që organizohet në Komunën e Vitisë për gjitha shpenzimet me një vend, e tash kur ka kërkesa të veçanta, pasqyrat financiare nuk e njohin sipas fshatrave, mirëpo nëse do një këshilltar me dit se sa ka investime në fshatra, se nga vjen ai, absolut këtë informatë keni me pas, mirëpo ato me i pasqyru në pasqyra financiare është e pamundshme. Buxheti nuk ndahet për koka banori të fshatrave. Ka pas shumë pyetje, po me e mira është ti bëni kërkesa, se problem me ju përgjigj unë kreytve pyetjeve që u parashtruan në këtë seancë.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. a) Nisma e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.
- b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.
- c) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Velika Pisanicës Republika e Kroacisë në fushën e ekonomisë, kulturës, arsimit dhe bashkëpunimit si në nxitjen e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndërmjet subjekteve ekonomike, institucioneve arsimore kulturore, sportive dhe shoqërisë.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Materialin e keni marr me kohë, ju kemi sjell edhe materialin shtesë që e keni kërkuar në KPF. Kosova sot nuk është anëtare e Bashkimit Evropian dhe pikërisht për me konkurrue në projekte të tilla, sidomos në IP3, po duhet me pas një partneritet me një komunë e cila është në shtetin që është në Bashkimi Evropian dhe pikërisht për këtë, përveç që jetojnë edhe shumë shqiptar në këtë komune, sidomos nga Komuna e Vitisë. Materialin e keni pranë me kohë, për pyetje dhe përgjigje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë.

znj.Mirlinda Sadiku: Shume mire që e keni pru një njoftim të shkurt për këtë komune, më intereson, cila është fusha, specifikisht a është parapa diëka, se nëse e keshyr aspektin ekonomik, ish komunë e rëngut të dytë ashtu ish pushteti lokal atje I rregulluar, nëse e keshyr kapacitetin ekonomik nuk ishin edhe fort komeditë sa të zhvilluar. Më tepër ish në aspektin bujqësor, ishin të njoftur për rritjen dhe kultivimin e kuajve, një ekip të hendbollit e kish, nuk e di sa muj me me perfitu prej tyre ata vet ishin përfitues te Komisionit Evropian në disa donacione. A keni mëndu në këtë aspekt apo vetëm që keni pas ftesë prej komunitetit shqiptar atje edhe komunitetit kroat, edhepse një përqindje, nëse nuk gaboje 23%, ishin edhe serb, prandaj cila është arsyeshmëria e plotë, sepse nuk ja vlen nëse është komunë me kapacitet të vogël ekonomike, çka do të përfiton Vitia, kur e dimë që nëse vinë ata njerëz, ne duhet ti akomodojmë, të shpenzojmë prej taksave tona. Edhepse, se nuk jemi kundër, e mbështesim, mirëpo duam një arsyeshmëri.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje për të gjithë! Unë nuk e di se çka po humbim në nëse bëjmë marrëveshje me ta. Aty është komunitetit shqiptar edhe kroat që kemi qenë se bashku gjithë jetën. Unë jam që të bëjmë miqësi me ta.

z.Bekim Azizi: Edhe në këtë informatë që naj sjellte, nuk po shkruan se sa shqiptar janë, po megjithatë na si grup jemi pro, edhepse nuk do të jetë një përfitim i madh, po do të përfitojnë njerëzit e Vitisë, te këtuhit që I

kemi atje. Për hirë të kësaj, ne do të jemi pro kësaj. Kisha kërku që këto marrëveshje që bëhen atje, ti sjellni në kuvend, të jemi të njoftuar edhe ne.

z.Ali Bajrami: Me këtë nismë të kryetarit, nuk shohë kurgja të keqe, vetëm një e mire dhe një afirmim të Kosovës, konkretisht Komunës së Vitisë. U ceken sferat e bashkëpunimit, ne si grup parlamentar jemi pro kësaj iniciative.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që kam qenë edhe unë në delegacion atje, ne si komunë nuk e kemi ndoshta direkt përfitimin nga ajo komunë, se nuk i ka mundësit, po në mënyrë të tërthortë ne fitojmë, që përmes kësaj komune fitojmë donacione nga Bashkësia Evropiane, sepse këta janë pjesë e Evropës. Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes ne votim këtë pikë ne paket, d.m.th të trijat a),b),c). Kush është që të miratohet kjo pikë. Me votat e të gjithëve u miratu kjo pikë.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për ndryshimin e vendimit Nr.01-410/03-71 i datës: 08.02.2018 të KKSB-së me kërkesën e Forcës së Sigurisë së Kosovës

Nënkryetari z.HasanAliu: Me udhëzim administrative caktohen anëtarët e KKSB-së, ndërsa Forca e Sigurisë së Kosovës, naj ka dërgua një kërkesë, që me ndërru anëtarin e saj, që është pjesë e KKSB-së. Materialin e keni para juve, për pyetje shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka për diskutim, pasi që nuk ka, e qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu edhe kjo pik e rendit të ditës.

Pika të pesë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për kompensimin e anëtarëve të Komisionit për zgjedhjen e kryetarëve dhe këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane

Kryesuesi z.Naim Pira: Ne e dimë që vitin e kaluar e kemi formuar një komision nga ana e këtij kuvendit, për zgjedhjen e këshillave të fshatrave. Këta janë tani ne proces, mirëpo këta duhet të kompensohen dhe para juve e keni propozim vendimi. Unë hapi diskutim për këtë pikë.

z.Taulant Haxhiu: Për votimet që po bëhen ne fshatrat e Komunës së Vitisë, na kemi edhe përfaqësuesin tonë aty, z.Regjepin, po shohim që ka shumë parregullsi, po votohet me vota të hapura, po votohet një kandidat, shumica e kandidatëve, po behet presion që kryetari i fshatit të jete nga LDK-ja. Kemi pas probleme ne Tërpezë, Kabash. Tash isha me kolegët e mij te Tetova, edhe një përfaqësues i fshatit Shushtë, tha u bë e padrejtë, u bë ajo u bë kjo. Është mirë te votohet me vota të mshefta, të zgjedhet ai që ka besim ndaj fshatit e jo të zgjedhet ne atë mënyrë siç dini ju, të bëni qashtu edhe ne Komunën e Vitisë. Nuk keni lajmëru, e keni zgjedh Xhilsime Qamili, kjo është shumë e ngarkume me punë, edhe doktorësh, edhe asambliste, e tash e keni bë edhe kryetare të qytetit të Vitisë, kjo është e pamatur. Kryetaret e fshatrave po zgjedhën në mënyrën me te vrazhdë nga LDK-ja, po doni që kreyt kryetarët e fshatrave të jenë nga LDK-ja. Jo more, ka edhe parti tjera. Është mirë që ne zgjedhjet ne fshatra tjera të behet me vota te mshefta. Sa i përket për mu pagu ata anëtarë, ne jemi si grup pro pagesës.

z.Basri Sylejmani: Na e kemi rregullore e cila e parasheh zgjedhjen ne mënyrë te msheftë dhe votimin e hapur. Janë masa ata që vendosin si të jet votimi. Te shushtë kanë qenë me votim të msheftë.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje! Unë mendoj që paraprakisht u kanë mirë me ju me caktu për formën e përzgjedhjes së anëtarëve te këshillave të fshatrave, se me të vërtet zgjedhje nuk ka, ka emërime që merren nëpër oda e jashtë dhe i bien aty, e këta i kryn do formalitete. Unë në Smirë e kam marr fjalën, kam kërku votim të msheftë, po nuk ka pas aty votim a me shku me të msheft apo si. Votim demokratik është votimi me vota të mshefta.

z.Sejdi Emini: Masi që po i japi të drejt që me vendos me i kompensu anëtarët e këtij komisioni, unë mendoj që ky kuvend ka përgjegjësi që këta kryetar të fshatrave duhet ta gëzoj edhe këta një të drejtë subvencioni, se është një punë e lodhshme edhe për ata që zgjedhën kryetar të fshatrave dhe t'i kompensojmë edhe ata, se me punu katër vite pa pagë edhe punë e lodhshme edhe shpenzim. Unë mendoj që kuvendi duhet të mendoj për ata.

z.Ali Bajrami: Anëtarët që i kemi votua ne e bëjnë një punë, një angazhim. Unë mendoj që duhet të kompensohen për punën e bërë. Ne si grup jemi pro këtij propozim vendimi.

z.Remzi Salihu: Edhe unë propozoj që këta të shkojnë vetëm me votim të msheftë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes në votim. Kush është që te miratohet ky propozim vendim? Nga të gjithë u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashtë të rendit të ditës kemi:

6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronat e paluajtshme të Komunës, Këshillit të Bashkësisë Islame në Viti.

Drejtoresha znj.Majlinds Ostroglava: Përshëndetje për të gjithë! Me këtë propozim vendim, propozohet ti jepet ne shfrytëzim prona e paluajtshme e Komunës se Vitisë, sipas kërkesës se Këshillit të Bashkësisë Islame ne Vitisë, pa procedurë të konkurrimit. Propozim vendimin e keni marr me kohë, për pyetje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës, pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të ditës.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendim për caktimin e lokacionit për vendosjen e shtatores kushtuar dëshmorit Safet Rexhepi nga Zhitia

Drejtoresha znj.Majlinds Ostroglava: Me këtë propozim vendim, propozohet të vendoset shtatorja e dëshmorit Safet Rexhepi nga Zhitia, sipas kërkesës së Këshillit Koordinues të fshatit Zhiti. Propozim vendimin e keni marr me kohë, për pyetjen shtesë jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pike e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

8. a) Nisma e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Kirchhain-Gjermani në kuadër të axhendes së OKB-së për vitin 2020-2030.

b) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për nismën e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me komunën e Kirchhain-Gjermani në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.

c) Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për autorizimin e kryetarit të komunës së Vitisë për nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar me Komunën e Kirchhain-Gjermani në kuadër të agjendës së OKB-së për vitin 2020-2030.

Kryesuesi z.Naim Pira: Zyra ligjore e MAPL-së, naj ka kthy këtë vendim dhe ka kërku që të sjellët edhe një herë në Kuvend, që të ndjeken procedurat ligjore. Nëse nuk ka për diskutim, unë e qes në votim. Kush është që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:20 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
